

FAP DURRES

(ctd.)

kompleton FAP Durres, duke shtuar:

- Shtojca 1. Fishat e Projekteve Lidhes te Bashkise se Re Durres.
- Shtojca 2. Organograma e Njesive Aktuale
- Shtojca 2. Organograme Bashkise se Re

*pergatitur nga Shtetiweb / CDI
Tirane, Prill 2015*



- Shtojca 1 -

FISHAT E PROJEKTEVE LIDHES

Projektet lidhes jane te lidhura me investime kapitale te desheruara ne territorin e Bashkise se Re Durres. Keto projekte jane rezultat i forumeve locale te organizuara nga CDI / Shtetiweb.org ne cdo njesi vendore te FAP Durres gjate muajve tetor 2014 – shkurt 2015.

Logjika e perzgjedhjes se projekteve mbeshetet ne metodologjine e ndjekur ne pergatitjen e FAP Durres:

- Fuqizimin e njesive dytesore ne raport me qendren e ardheshme adminsitaraive;
- Krijimin e lidhjeve paralele me njesive dytesore dhe jo vetem koncentrike drejt qendres;
- Mbeshtetjen e krijimit te komuniteteve funksionale ne njesite periferike;
- Forcimin e kontrollit te territorit permes thurjes se nje rrjeti kapilar komunikimesh
- Promovimi dhe mbeshtetjen e aktiviteteve endogjene;
- Promovimin strategjik te njesive dytesore si hapshire zhvillimi per qytetin e Durresit, dhe si oportunitet unik per Durresin 2020.

Kushti per tu perzgjedhur eshte perfitimi i me shume se ne njesie vendore nga ky project. Dmth praktikisht dhe pse propozimi vjen nga nje bashki ose komune, jane jo vetem banoret / bizneset e kesaj njesie por dhe banore / biznese te te pakten nje njesie tjeter qe do te perfitojne nga ky investim.

Te gjitha vendet potenciale te projekteve jane vizituar dhe konstatuar ne terren.

Sektoret e zgjedhur jane te shumte dhe nuk ka pasur kufizime.,pervec faktit qe duhet te jene – te pakten pjeserisht – competence e pushtetit local.

Buxheti i projekteve eshte pershtatur me mundesite reale te pushteit local dhe / ose te burimeve te tjera realiste (kryesisht donator). CDI / Shtetiweb.org ka evituar riciklimin e projekteve te vjetra dhe / ose perpilimin e nje wish-list me projekte te refuzuara nga Fondi I Zhvillimit / struktura te tjera te ngjashme.

Per Qytetin e Durresit nuk kemi vene se aty:

- 1) po i kryen Fondi I Zhvillimit te Rajoneve (shih FAP Durres), dhe
- 2) per neve Durresi per tre vitet e para duhet et fokusohet kryesisht tek procesi i Amalgamimit (qe po behet nga KPMG & STAR II).



Fisha e projektit nr. 01

1. Të dhëna të përgjithshme

Titulli i projektit	Rikonstruksioni i shkollës 9 vjeçare
Lloji i projektit	Kohezion Social/ Zhvillim Ekonomik
Vendndodhja e projektit	Katund i Ri
Vlera totale e projektit in EUR (est.)	250K

2. Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve (max 10 rreshta)

Zona bujqësore/ aktivitetet në Katundin e Ri dhe në Bashkinë Durrës janë duke vuajtur nga mungesa e ekspertëve teknike bujqësor të kualifikuar.

Ne shkollën ekzistuese në Katundin e Ri organizohet mesim për nxënës të ciklit 9-vjeçar (450 nxënës) dhe të mesëm (400 nxënës). Një pjesë e madhe e nxënësve jetojnë në njesite vendore fqinje. Një ide e mirëpritur do të ishte shtimi i një qendre trajnime profesionale të specializuar për bujqësinë në këtë shkollë.

Shkolla e Mesme ekzistuese kishte fillimisht një cikël trajnime profesionale që ofronte trajnime në bujqësi dhe në zoo-teknikë. Por prej shumë vjetësh ky trajnim nuk ofrohet më. Duke pasur parasysh profilin bujqësor të zonës, vihet re mungesa e kuadrove të mesëm në bujqësi.

3. Qëllimi/et specifik të projektit (max. 4-5 rreshta)

Qëllimi i rikonstruksionit të shkollës 9-vjeçare është përmirësimi i organizimit të mesimdhënis dhe formimi i ekspertëve të bujqësisë të cilët do të shërbejnë zhvillimit ekonomik të zonës.

Ri-profilizimi i Shkollës së Mesme të KiR-it drejt formimit profesional për zonën, të kompletuar me laborator/mësimdhënie dhe parcelë bujqësore eksperimentale do të krijojë një pol zhvillim bujqësor në Katundin e Ri që do të shërbejë Bashkisë Durrës dhe Bashkive të tjera fqinje.

4. Rezultatet e pritshme dhe treguesit (max 5-6 rreshta)

Perfitimet e këtij projekti përfshijnë: (a) përmirësimi i organizimit dhe cilësisë së mesimdhënis; (b) krijimi i ekspertëve bujqësorë të kualifikuar që do të shërbejnë zonës etj. Nga rikonstruksioni i shkollës 9 vjeçare do të përfitojnë jo vetëm banorët e Katundit të Ri, por edhe ata të zonës funksionale. Numri i NJA që përfitojnë nga kjo nderhyrje është 6 (gjashtë). Shkolla mund të kompletohet dhe me laboratore dhe parcela të vecanta që do të rrisin vlerën e shtuar të prodhimeve vendore përmes identifikimit të produkteve të pershtashme për këtë zonë.

5. Aktivitetet e projektit (5-6 rreshta)

Kohezagjatja e përafert e projektit 6-12 muaj për ri-konstruksionin fizik. Aktivitete e parashikuara përfshijnë kryerjen e punimeve të brendshme dhe të jashtme rikonstruksioni. Parashikohet që projekti të zbatohet në periudhën e pushimeve verore



ndermjet viteve shkollore per punet qe prekin mesimdhenien, kjo per te mos ndikuar ne vazhdimesine e ciklit mesimor dhe per shkak te kushteve te favorshme te motit te kete periudhe.

Persa i perket futhes se kurrikulimit te ri per bujqesine, nevojiten negociata me Ministrine e Arsimit, dhe nje kohe me e gjate.

6. Maturimi i projektit (5-6 rreshta)

Parashikohet te kryhet nje vleresim i situates se godines se shkolles 9 vjecare. Ne baze te ketij vleresimi do te kryhet nje vleresimi i nevojave per nderhyrje.

Po ashtu duhet te behet nje studim fizibiliteti mbi koston dhe perfitimet e hapjes se kurrikulas ne VET bujqesi per te gjithe zonen.

7. Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim (3-4 rreshta)

Burimi i mundshem finacimi eshte Fondi i Zhvillimit te Rajoneve, GIZ, etj.

Partnere ne zbatim i ketij projekti Drejtoria Rajonale Arsimore, Ministria e Arsimit, Ministria e Bujqesise, NJA Katund i Ri etj.

8. Kostot e projektit (3-4 rreshta)

Kostoja eshte vleresuar mes EUR 250K dhe 500K ne varesi nga rendesia e nderhyrjes.



Fisha e projektit nr. 02

1. Të dhëna të përgjithshme

Titulli i projektit	Rehabilitimi i Qendrës Kulturore
Lloji i projektit	Kohesion Social
Vendndodhja e projektit	Katund i Ri
Vlera totale e projektit EUR (est.)	430K

2. Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve (max 10 rreshta)

Ne te gjithë zonen e Bashkise se Re Durres, Pervec se ne qytetin e Durresit vetem ne Katundin e Ri ka nje qender te vetme multi-kulturore me nje kapacitet prej 400 personash qe ndodhet ne pronesi publike. Edhe pse kjo qender mund te mireprese nje numer te konisderueshem dashamires te aktiviteve kulturore – vleresohet me kapacitet 350 ulese, situatë ne te cilen ajo ndodhet ul ndjeshem frekuentimin e saj. Vihet re qe kjo qender ka nevoje per rehabilitim te ambjenteve te brendshme dhe te jashtme per te siguruar nje qendrim sa me te kendshem frekuentuesve te saj, dhe zhvillime cilesore te aktiviteve kulturore.

Alternativa eshte ne jete kulturore e banoreve rurale e kufizuar ne kafete e fshatit ose ne pikat e llotove te ndryshme.

3. Qëllimi/et specifik të projektit (max. 4-5 rreshta)

Qëllimi i rikonstruksionit te qendres kulturore eshte krijimi i nje mjedisi te pershtatshem per aktivite kulturore, rinore dhe manifestime publike te ngjashme duke i dhene KiR nje rol te rendesishem ne organizimin e aktiviteve social-kulturore per te gjithë zonen.

Per nga afersia gjeografike, ketu n+mund te vijne dhe banore nga Sukthi dhe Manza, si dhe nga njesi te tjera.

4. Rezultatet e pritshme dhe treguesit (max 5-6 rreshta)

Perfitimet e ketij projekti perfshijne: (a) perfshirje me e madhe e banoreve (kryesisht te rinjve) te banoreve te kesaj NJA ne aktivitetet kulturore; (b) permiresimi i kohezionit social; (c) permiresimi i cilesise se jetes. Nga rikonstruksioni i Qendres Kulturore do te perfitojne jo vetem 10,161 banoret e Kantundit te Ri, por gjithë banoret e zones funksionale (175,110 banore, pse jo dhe Durresi). Numri i NJA qe perfitojne nga kjo nderhyrje eshte 6 (gjashte).

5. Aktivitetet e projektit (5-6 rreshta)

Kohezgjatja e perafert e projektit 6 muaj – 1 vit. Parashikohet qe projekti te zbatohet ne nje periudhe te pershatshme klimatike dhe ne perputhje me kalendarin e aktiviteve kulture te qendres.

Aktivite e parashikuara perfshijne kryerjen e punimeve te brendshme dhe te jashtme rikonstruksioni, si dhe re-habilitimin e infrastruktures audio.



6. Maturimi i projektit (5-6 rreshta)

Parashikohet te kryhet nje vleresim i situates se godines se qendres kulturore. Ne baze te ketij vleresimi do te kryhet nje vleresimi i detajuar i nevojave per nderhyrje (teknike dhe financiare).

Faza a dyte do te jete pergatitja e TORs, prokurimi, kontraktimi & zbatimi.

7. Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim (3-4 rreshta)

Burimi i mundshem finacimi eshte fondi i Ministrise se Kultures per zhvillimin dhe zbatimin e projekteve kulturore. Partnere te mundshem ne zbatimin e ketij perfshijne Ministrine e Kultures, Komunen e KiR, Organizata kulturore etj.

8. Kostot e projektit (3-4 rreshta)

Nga 200K ne 650K, ne varesi te pajisjeve.



Fisha e projektit nr. 03

1. Të dhëna të përgjithshme

Titulli i projektit	Ngritja e laboratorit klinik në qendrën shëndetësore
Lloji i projektit	Kohesion Social
Vendndodhja e projektit	Ishëm
Vlera totale e projektit (EUR) est.	30K+

2. Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve (max 10 rreshta)

NJA Ishëm përfshin 11 fshatra me 8,500 banorë. Ajo ka një distancë relativisht të madhe gjeografike me NJA e tjera fqinje (Manëz dhe Katund i Ri). Në Ishëm ka një qendër shëndetësore, në të cilën për shkak të mungesës së një laboratorit klinik, nuk mund të kryehen analizat baze shëndetësore. Për këtë arsye banorët janë të detyruar të udhetojnë drejt Fushe-Krujes apo Durrësit.

3. Qëllimi/et specifik të projektit (max. 4-5 rreshta)

Qëllimi i projektit është ngritja e laboratorit klinik për analizë gjak dhe urine komplet në qendrën shëndetësore të Ishëmit dhe furnizimin e saj me materialet e nevojshme për analizat baze shëndetësore për të paktën një vit. Ky laborator do të shërbejë jo vetëm popullatën e Ishëmit por dhe NJA fqinje (kryesisht Manëz).

4. Rezultatet e pritshme dhe treguesit (max 5-6 rreshta)

Rezultatet e pritshme përfshijnë: (a) ofrimi i plotë dhe i përmirësuar i shërbimit të banorëve të kësaj NJA; (b) përmirësimi i kohëzimit social; (c) përmirësimi i cilësisë së jetës. Nga ngritja e laboratorit klinik do të përfitojnë 8,500 banorët e Ishëmit, por edhe banorët e NJA fqinje si Manëz dhe KiR. Numri i NJA që përfitojnë nga kjo ndërhyrje është 2-3 (dy-tre).

5. Aktivitetet e projektit (5-6 rreshta)

Kohezgjatja e përafërt e projektit 3-4 muaj.

Aktivitetet e parashikuara përfshijnë identifikimin dhe blerjen e pajisjeve laboratorike dhe materialeve për kryerjen e analizave, duke ndjekur procedurat përkatëse të prokurimit dhe blerjen. Rëndësi do të ketë dhe testimi dhe trajnimi i stafit.

6. Maturimi i projektit (5-6 rreshta)

Parashikohet të kryhet një vlerësim dhe listim paraprak i pajisjeve të nevojshme dhe materialeve baze dhe i burimeve njerëzore. PO ashtu në bashkëpunim me drejtorinë e shëndetësisë do të bëhet përcaktimi i aparaturave teknike të laboratorit të ri, dhe struktura organizative përkatëse.



7. Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim (3-4 rreshta)

Burimi i mundshëm financimi është skema për mbështetjen e reformës në shëndetësi financuar nga SDC (Swiss Development Cooperation), fondi i Ministrisë së Shëndetësisë etj.

Partnerë të mundshëm në zbatim të këtij përfshijnë Ministrinë e Shëndetësisë, Drejtorinë Rajonale të Shëndetit Publik, Komunën e NJA Ishëm etj.

8. Kostot e projektit (3-4 rreshta)

Nga EUR 30K e sipër.



Fisha e projektit nr. 04

1. Të dhëna të përgjithshme

Titulli i projektit	Ndergjegjesimi per Ambientin: Pastrimi i lumit Ishëm
Lloji i projektit	Zhvillim Ekonomik
Vendndodhja e projektit	Ishëm
Vlera totale e projektit (EUR) est.	37K

2. Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve (max 10 rreshta)

Lumi Ishem (74 km) kalon ne pjesen qendrore te Shqiperise dhe derdhet ne Kepin e Rodonit, NJA Ishëm. Ne lumin Ishem grumbullohen mbeturina te llojeve te ndryshme (si p. sh., industiale, teknologjike, ujrat e zeza, bujqesore, ushqimore etj.) qe sjellin 3 lumenj te tjere: lumi i Tiranës, perrenjte Tërkuza dhe Zeza. Keto mbeturina shkaktojne ndotje te ujrave siperfaqesore dhe nentokesore. Dihet qe ndotja e ujit te lumenjve ka nje ndikim te drejteperdrejte dhe ndikon shume negativisht ne shendetin e banoreve qe e perdorin apo jetojne ne zonat perreth dhe ne ekosistemin e lumit, i cili ben shpeshhere pastrimin e ujit.

Mbi te gjitha Ishmi sjell tonelata me mbetje qe derdhen dhe depozitohen ne bregun e detit dhe qe ndikojne negativisht ne ekosistem dhe ne turizem.

3. Qëllimi/et specifik të projektit (max. 4-5 rreshta)

Qëllimi i projektit eshte ndergjegjesimi i banoreve te Bashlis es e Re Durres dhe permes tyre, dhe i banoreve te zonave nag merr uje Ishmi per nevojen poer majtjen et epaster te lumit. Ne final kjo do ti sherbeje permiresimit te cilesise se ujit te lumit Ishëm dhe ulja e volumit te mbetjeve qe derdhen ne Adriatik. Kjo do te sherbeje nje permiresimin e cilesise se ambientit ne kete NJA dhe ne gjithë ZF.

4. Rezultatet e pritshme dhe treguesit (max 5-6 rreshta)

Rezultatet e pritshme perfshijne: (a) ndergjegjesimin e te rinjve te NjA nga kalon Ishmi mbi nevojen per ta mbajtur lumin te paster; b) krijimin e lidhjeve tekohezionit mes te rinjve te BRD; c) permiresimi i cilesise se ujit te lumit Ishem; (d) permiresimi i kushteve mjedisore ne NJA dhe ne ZF; e) permiresimi i cilesise se jetes se banoreve te zones; f) rritja e pastertise dhe cilesise se bregut te detit dhe rritja e atraksionit turistik te te gjithë zones bregdetare.

Pastrimi i lumit Ishem do te ndikojne ne cilesin e jete se 5,000 banoreve te Ishmit dhe te banoreve te NJA fqinje dhe te turisteve qe vijen te perfitojne nga bregu i detit. Numri i NJA qe perfitojne nga kjo nderhyrje eshte 2-3 (dy-tre). Po ashtu ky aksion do te krijojë lidhje mes banore te BRD qe perfitojne nga Ishmi dhe perrenjte qe derdhen ne te, si dhe mes banoreve te BRD dhe te bashkive nga burion Ishmi per te koordinuar perpjektjet per ta mbajtur te paster lumin dhe detin.

5. Aktivitetet e projektit (5-6 rreshta)



Kohezgatja e perafert e projektit 3-4 muaj.

Aktivite e parashikuara perfshijne: (a) vleresimi i treguesve te ndotjes fizike, kimike dhe biologjike; (b) vleresimi teknik dhe financiar i nevojave per nderhyrje; (c) promovimi ne shkolla te zgjedhura nga disa njesi administartive; d) kryerja e pastrimit te ujit te lumit nga te rinjte dh epromovimi i tyre ne mediat lokale dhe kombetare; (d) aktivite ndergjegjesuese per mbrojtjen e uji te lumit ne NJA Ishem dhe fqinje.

Ky aktivitet parashikon nderhyrjen ne te gjithë lumin dhe ne ate te tributareve te saj, Terkuza dhe Zeza qe ndodhen jashte kufijve te Bashkise se Re Durres. Si i tille, duhet te koordinohet me Bashkite te tjera.

6. Maturimi i projektit (5-6 rreshta)

Parashikohet te kryhet nje vleresim i situates aktuale dhe shkalles se ndotjes se lumit Ishem dhe identifikimin e nevojave per nderhyrje.

Menyra me e mire per ta bere kete aktivitet do te ishte me nderhyrje vullnetare dhe me sensibilizimi te komuniteteve qe jetojne buze lumit dhe tributareve te tij.

7. Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim (3-4 rreshta)

Burimi i mundshem finacimi jane skema te parashikuar per permiresimin e mjedisit te donatoreve si BE, GIZ, fondi i Ministrise se Mjedisit, Bashkia Durres etj.

Partnere te mundshem ne zbatim e ketij perfshijne Ministrine e Mjedisit, Agjencia Kombetare e Mjedisit, Bashkia Durres etj.

8. Kostot e projektit (3-4 rreshta)

EUR 37K



Fisha e projektit nr. 05

1. Të dhëna të përgjithshme

Titulli i projektit	Studimi i fizibilitetit për rindërtimin e urës që lidh fshatin Jubë (Komuna e Katundit të Ri) me të fshatit Rrushkull (Komuna e Sukthit).
Lloji i projektit	Zhvillim Ekonomik
Vendndodhja e projektit	Sukth
Vlera totale e projektit EUR (est.)	11,5K

2. Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve (max 10 rreshta)

Ura e tanishme që lidh fshatin Jubë (Komuna e Katundit të Ri) me të fshatit Rrushkull (Komuna e Sukthit) është ushtarake dhe lejon kalim vetëm për automjete të lehta. Per kete arye levizshmeria, komunikimi dhe shkembimi i mallrave dhe banoreve midis dy fshtrave/komunave eshte i kufizuar. Paraprakisht vleresohet se rindertimi i ures ekzistuese duke e zgjeruar dhe duke ndryshuar konstruktin e saj (prej druri ne beton) do te rrise ndjeshem nivelin e shkembimit dhe komunikimit ndermjet fshatrave te dy NJA-ve, do te permiresoje zhvillimin ekonomik dhe cilesise se jetes se banoreve te ZF. Gjithesesi, nje studimi fizibiliteti, i cili do te mund vleresoje gjendjen e ures aktuale dhe nevojat teknike dhe financiare per rindertimin e saj. Pergatitja e dokumentit te projektit mund te mbështetet me një MoU ndërmjet Katundit të Ri dhe Sukthit për të bashkë-aplikuar për fonde të reja për investime për urën.

3. Qëllimi/et specifik të projektit (max. 4-5 rreshta)

Qellimi i projektit eshte kryerja e nje studimi te hollesishem fizibiliteti, i cili do te mund te vleresoje rindertimin e ures ekzistuese. Rindertimi do te synoje permiresimin e levishmerise dhe shkembimit te mallrave dhe banoreve ndermjet dy fshatrave/komunave pjese e ZF.

4. Rezultatet e pritshme dhe treguesit (max 5-6 rreshta)

Rezultatet e pritshme perfshijne: (a) realizimin e nje studimi fizibiliteti i cili do te vleresoje nevojen dhe mundesite e rikonstruksionit te ures eksistuese.

Kryerja e studimit dhe potencialisht rikonstruksioni i ures do te ndikojne ne cilesin e jete se 26,127 banoreve (15,966 banoreve te Sukthit dhe 10,161 banoreve te KiR). Numri i NJA qe perfitojne nga kjo nderhyrje eshte 2 (dy).

5. Aktivitetet e projektit (5-6 rreshta)

Kohezgjatja e perafert per kryerjen e studimit te fizibilitetit eshte 8 muaj, perfshire dhe prokurimin & kontraktimin.

Aktivite e parashikuara perfshijne: (a) vleresimin teknik te gjendjes se ures ekzistuese; (b) vleresimi teknik dhe financiar i nevojave per nderhyrje; c) pergatitja e TORs; d) prokurimi & kontraktimi, e) implementimi.



6. Maturimi i projektit (5-6 rreshta)

Edhe pse rikonstruksioni i ures vleresohet si shume i nevojshme nga te dyja NJA dhe banoret e zones, deri tani nuk eshte ndermarre ndonje veprim konkret per kryerjen e ndonje studimi fizibiliteti per rikonstruksionin e saj. Projekti synon pikerisht kryerjen e ketij studimi, i cili do te beje nje vleresim te situates aktuale dhe dhe identifikimin e nevojes per nderhyrje.

7. Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim (3-4 rreshta)

Burimi i mundshem finacimi jane fondet publike te Nja-ve, dhe / ose dldp.

8. Kostot e projektit (3-4 rreshta)

EUR 11.5K



Fisha e projektit nr. 06

1. Të dhëna të përgjithshme

Titulli i projektit	Planifikim lokal per Rikualifikim urban në Bashkinë e Sukthit
Lloji i projektit	Kohezion Social
Vendndodhja e projektit	Sukth
Vlera totale e projektit (EUR) est.	7,2K

2. Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve (max 10 rreshta)

Ne Bashkinë e Sukthit pothuajse mungojne hapësirat e perbashketa per pushim dhe argetim te komunitetit p.sh. parqet, kënde lojrash, hapësira kulturore & artistike, etj. Zhvillimi urban i bashkise i ka marre komunitetit hapësirat e perbashketa dhe privatizimi i ka kaluar ato ne duart e operatoreve private. Kjo sigurisht ndikon negativisht ne cilesine e jetes se banoreve te kesaj bashkie dhe ne humbjen e lidhjeve qytetare dh ete komunitetit. Po ashtu ka ndikim negativ dhe ne rritjen dhe edukimin e te rinjve.

Projekti do te identifikojte zonat dhe investimet perkatese per te promovuar ri-kualifikimin urban te Qytezes se Sukthit.

3. Qëllimi/et specifik të projektit (max. 4-5 rreshta)

Qëllimi i projektit eshte pergatitja e nje plani lokalqe synon permiresimin e situates se infrastruktures komunitare urbane ne Bashkine e Sukthit. Ky do te ishte nje Dokument Pune qe do te paraqeste dhe do te mundesoje krijimin e zonave te perbashketa argetuese per komunitetin si p.sh. parqe, kende lojrash etj. Kjo do te sjelle permiresimin e cilesise se jetes se banoreve te Bashkise Sukth.

Ky dokument dp ti paraqitej Bashkise se Re Durre sper mbeshtetje.

4. Rezultatet e pritshme dhe treguesit (max 5-6 rreshta)

Rezultatet e pritshme perfshijne: (a) pergatitja e planit te ri-kualifikimit urban; b) promovimi i tij ne Bashkine e Re. Qëllimi perfundimtar do te ishte krijimi i zonave te perbashketa argetuese per komunitetin lokal ne qytezen e Sukthit dhe permiresimi i cilesise se jetes se komunitetit. Ky shembull do te perdorej per te ndertuar projekte te ngjashme ne te gjitha njesite e tjera te Bashkise se Re Durres.

Rikualifikimi urban dhe krijimi i zonave te perbashketa argetuese do te ndikojte ne permiresimin e jetes se 15,966 banoreve te Sukthit, dhe te disa fshatrave qe i perkasin njesive fqinje.

5. Aktivitetet e projektit (5-6 rreshta)

Kohezgjatja e perafert per zbatimin e rikualifikimit urban eshte 16 muaj.

Aktivitetet e parashikuara perfshijne: (a) pergatitjen e eplanit me vleresimin teknik te hapësirave ekzituese; (b) promovimin ne Bashkine e RE.



Ne rast sukseesi do te pasihet nga perгатitja e TORs & BoQ; prokurimi & tenderimi, d) kontraktimi & kryerja e punimeve te rikualifikimit; dhe eromovimi ne njesite e tjera admisniatrtive te Bashkise se Re Durres.

6. Maturimi i projektit (5-6 rreshta)

Aktualisht nuk evidentohet kryerja e ndonje studimi fizibiliteti per rikualifikimin urban te Bashkise Sukth. Sdq sheshet dhe objektet jane paracaktuar nga Bashkia.

7. Burimet e financimit dhe partneret ne zbatim (3-4 rreshta)

Burimi i mundshem finacimi jane fondet publike te NJA Sukth, dhe ose Fondi i Zhvillimit te Rajoneve.

8. Kostot e projektit (3-4 rreshta)

EUR 7,2K.



Fisha e projektit nr. 07

1. Të dhëna të përgjithshme

Titulli i projektit	Krijimi i "Rruges e veres"
Lloji i projektit	Zhvillim ekonomik / Kohezion Social
Vendndodhja e projektit	Manez dhe Sukth
Vlera totale e projektit (EUR) est.	21K

2. Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve (max 10 rreshta)

Zona e Manzes dhe e Bashkise Sukth eshte e njohur per prodhimin e veres dhe te djathit. Por vihet re qe cilesite dhe vlera e ketyre produkteve nuk jane promovuar mjaftueshem nga njesite e pushtetit vendor apo nga iniciativa private apo joqeveritare. Krijimi i "Rruges se Verës", e cila kalon përmes Komunës së Manzës-Bashkisë së Sukthit-Kullë-Përlot do të mundësojë promovimin e produkteve shtëpiake prodhuar nga vreshtarë dhe fermerë të NJA-ve kryesisht verën, djathin etj .

Edhe pse turizmi ne Bashkine e Re Durrës është orientuar tërësisht drejt plazhit vihet re keto shqetësime: a) përveç plazhit të Lalzit pjesa tjetër e linjës së detit është e dëmtuar nga zhvillimi urban; b) është përqendruar në turizëm me të ardhura të ulëta; c) është i përqendruar vetëm gjatë 2,5 muajve të vitit. Si i tillë turizmi ka një ndikim minimal dhe nuk ka vlerë të ndjeshme shtesë për ekonominë e zonës.

Ne keto kushte "Rruga e Verës" do të jetë një iniciativë e mirepritur për të promovuar turizmin e brendshëm.

3. Qëllimi/et specifik të projektit (max. 4-5 rreshta)

Qëllimi i projektit eshte promovimi i produkteve shtëpiake te prodhuara nga vreshtare dhe fermere (si p.sh. vera dhe djathi etj.) te zones dhe promovimi i turizmit te brendshem ne ZF.

Përmes turizmit tokësor, Bashkia Durrës mund: a) të promovojë dhe të ofrojë produkte vendase duke ndikuar drejtpërdrejt të ardhurat e banorëve rurale; b) rritjen e zgjedhjeve të turistëve duke ofruar alternativa për turizmin detar; c) të promovojë profilin e zonës; d) madje edhe të behet terheqes për banorët e Tiranën apo zonave të tjera urbane.

4. Rezultatet e pritshme dhe treguesit (max 5-6 rreshta)

Rezultatet e pritshme perfshijne: (a) krijimi i nje rruge gastronomike; (b) permiresimi i nivelit te turizmit te brendshem ne ZF Durres.

Krijimi i rruges se veres do te ndikojë direkt ne permiresimin e jetes se banoreve te 2 (dy) NJA-ve Manez dhe Sukth (15,966 banoreve te Sukthit dhe 6,652 banoreve te Mazes), kryesisht vreshtareve dhe fermereve qe prodhojne produkte tipike te zones. Ndikimet pozitive te zbatimit te projektit do te ndjehen jo vetem ne keto dy NJA, por ne te gjithë Bashkine e Durresit.

5. Aktivitetet e projektit (5-6 rreshta)



Kohezgjatja e perafert per zbatimin e projektit eshte 6 muaj.

Aktivitetet e parashikuara perfshijne: (a) identifikimi i produkteve gastronomike tipike te zones, dhe te veres ne vecanti; (b) identifikimi i vreshtareve dhe fermereve qe kane interes ne prodhimin dhe promovimin e produkteve tipike; (c) shenjimi/markimi i rruges; (d) promovimi i kesaj rruge nepermjet aktiviteteteve promovuese dhe hartimin e materialeve promovuese; e) permiresimi i lokaleve pritese per turistet per prodhues te seleksionuar dhe pajisja e tyre me logo, website dhe material promovues (perfshire gota, broke, etj), f) vendosja e hartave turistike per Rrugen e Veres ne vende kyc si porti, bashkia, etj.

6. Maturimi i projektit (5-6 rreshta)

Aktualisht nuk evidentohet kryerja e ndonje studimi fizibiliteti.

7. Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim (3-4 rreshta)

Burimi kryesor eshte dldp. Burimi te tjera te mundshme finacimi jane skema granti te donatoreve te ndryshem qe mbeshtesin promovimin dhe zhvillimin e turizmit (si p.sh. BE, UNDP, Italian Cooperation etc.), fonde te Ministrise e Zhvillimit Urban dhe Turizmit dhe Ministrise se Bujqesise, Zhvillimit Rural dhe Administrimit te Ujrave Si partnere te mundshem ne zbatim te ketij projekti mund te permenden Agjensia Kombetare e Turizmit, NJA Manez dhe Sukth etj.

8. Kostot e projektit (3-4 rreshta)

EUR 21K



Fisha e projektit nr. 08

1. Të dhëna të përgjithshme

Titulli i projektit	Krijimi i Kompleksit Sportiv - Manez
Lloji i projektit	Zhvillim ekonomik / Kohezion Social
Vendndodhja e projektit	Manez
Vlera totale e projektit (EUR) est.	35K

2. Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve (max 10 rreshta)

Bashkia e Manzës është e vetmja që ka të përgatitur një Plan Zhvillimi Urban (dhe pse të pa-aprovuar akoma). Logjika themelore e këtij plani është që të ofrojë shërbime jo vetëm për bashkinë e Manzës (duke qënë se nuk ka popullatën e nevojshme apo veprimtarinë ekonomike), por dhe për Durrësin, Ishmin, Rashbullin, Katundin e Ri.

Nje nga projektet e identifikuar ne Planin e Zhvillimit Urban eshte krijimi i Zonës së Kompleksit Sportiv Multi-Sport. Kjo zone do ti sherbeje kohezionit social dhe zhvillimit rinor ne Manze, Ishem, Katund te RI dhe ne njesi te tjera limitrofe.

3. Qëllimi/et specifik të projektit (max. 4-5 rreshta)

Qellimi i projektit eshte rritja e games se mundesise se argetimeve sportive per permiresimin e nivelit dhe cilesise te ofrimit te tyre per banoret e Manzes, Ishmit (pushuesit e Gjirit te Lalzit), Katundit te Ri, etj. Aktivitete sportive do kontribuojne ne rritjen e lidhjeve mes te rinjve te Bashkise se Re Durres. Po ashtu per pushuesit e Gjirit te Lalzit do te ofrohen sherbime cilesore qe do te ndikojne ne rritjen e te ardhurave te zones.

4. Rezultatet e pritshme dhe treguesit (max 5-6 rreshta)

Rezultatet e pritshme perfshijne: (a) pasurimi i games se argetimeve per banoret e zones (Manez, Ishem, KiR, etj); (b) permiresohet cilesia e sherbimeve per pushuesit e Gjirit te Lalzit; (c) rritet niveli i interesit te popullates per te kaluar pushimet ne Gjirin e Lalzit dhe numri i pushuesve; (d) rriten te ardhurat e aktivitetet sportive.

5. Aktivitetet e projektit (5-6 rreshta)

Kohezgjatja e perafert per zbatimin e projektit eshte 12 muaj.

Aktivitete e parashikuara perfshijne: (a) vleresimi i nevojave dhe planifikimi i nderhyrjes fillimisht me investime minimale (football / basketboll / tenis); (b) tenderimi, kontraktimi, zbatimi i punimeve; c) promovimi ne zone.

6. Maturimi i projektit (5-6 rreshta)

Aktualisht nuk evidentohet kryerja e ndonje studimi fizibiliteti.

7. Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim (3-4 rreshta)



Burimi i mundshem financimi jane fonde publike te Bashkis es e Re Durres ose fonde publike-private.

8. Kostot e projektit (3-4 rreshta)

EU 35K



Fisha e projektit nr. 09

1. Të dhëna të përgjithshme

Titulli i projektit	Kompletimi & perditesimi i Planit te Zhvillimit Urban - me theks Zona e Shërbimit të Mbështetjes me Sherbime Tregtare Plotesuese
Lloji i projektit	Zhvillim ekonomik / Kohezion Social
Vendndodhja e projektit	Manez
Vlera totale e projektit (EUR) est.	15K

2. Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve (max 10 rreshta)

Bashkia e Manzës është e vetmja që ka të përgatitur një Plan Zhvillimi Urban (dhe pse të pa-aprovuar akoma). Logjika themelore e këtij plani është që të ofrojë shërbime jo vetëm për bashkinë e Manzës (duke qënë se nuk ka popullatën e nevojshme apo veprimtarinë ekonomike), por dhe për Durrësin, Ishmin, Rashbullin, Katundin e Ri.

Nje nga projektet e identifikuar ne Planin e Zhvillimit Urban eshte krijimi i Zonës së Shërbimit të Mbështetjes me Sherbime Tregtare Plotesuese. Kjo zone do ti sherbejne zhvillimit urban të Gjirit të Lalzit. Ky plan duhet te pershtatet me territorin dhe profilin socio-ekonomik te Bashkise se Re. N eketë faze ne duam te fokusohemi tek komponenti i Zonës së Shërbimit të Mbështetjes me Sherbime Tregtare Plotesuese (ZSMSTP).

3. Qëllimi/et specifik të projektit (max. 4-5 rreshta)

Objektivi i projektit eshte adaptimi, promovimi dhe aprovimi i planit te ZSMSTP nga Bashkia e Re Durres. Qellimi perfundimtar eshte permiresimi i nivelit dhe cilesise te ofrimit te sherbimeve tregtare sherbimeve per banoret e Manzes, por kryesisht per pushuesit e Gjirit te Lalzit.

4. Rezultatet e pritshme dhe treguesit (max 5-6 rreshta)

Rezultatet e pritshme pervec valorizimit te punes se kryer deri me tani nga njesite aktuale, perfshijne: (a) rritja e numrit te sherbimeve dhe permiresimi i nivelit te tyre; (b) permiresohet cilesia e sherbimeve per pushuesit e Gjirit te Lalzit; (c) rritet niveli i interesit te popullates per te kaluar pushimet ne Gjirin e Lalzit dhe numri i pushuesve; (d) permiresohet dhe promovohet turizmi detar.

Krijimi i kompleksit sportiv do te ndikojë direkt ne permiresimin e nivelit te sherbimeve qe do u ofrohen direkt 6,652 banoreve te Manzes dhe pushueseve te Gjirit te Lalzit.

5. Aktivitetet e projektit (5-6 rreshta)

Kohezgjatja e perafert per zbatimin e projektit eshte 6 muaj.

